



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1422/2 prot.

Tiranë, më 30. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 153, datë 30. 10. 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 119, datë 20.10.2020, e shtetasit L. S., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në Ministrinë e Brendshme (në vijim MZSH), ish-Prefekti i Qarkut Berat, V. Z. dhe deputetit të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, F. Y., me pretendim diskriminimin për shkak të “*bindjeve politike*”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, në mes të tjerash, subjekti ankues deklaron se është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë Berat më datë 06.12.2013. Në muajin tetor 2016, ankuesi është larguar nga anëtarësimi në subjektin politik Partia Socialiste e Shqipërisë, duke u anëtarësuar në subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim (në vijim LSI). Që nga momenti i anëtarësimit në LSI, ankuesi pretendon se ka marrë kërcënime nga ana e disa punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në Ministrinë e Brendshme, nga Deputeti F. Y. dhe nga ish-Prefektja e Qarkut Berat, V. Z., për largimin e tij nga puna. Në vijim, 2 (dy) ish punonjës të MZSH-së, kanë depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, ndaj ankuesit për veprën penale “*Shpërdorim*

¹ Referuar Kartës së Anëtarësisë nr. 38667, datë 24.10.2016, është anëtarë i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim

detyre”. Në këto kushte, referuar pikës² 3 të nenit 15 dhe pikës³ 2 të nenit 17 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, ankuesi me Urdhër Nr. 1286, datë 11.12.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, është pezulluar nga detyra për shkak të procedimit penal të nisur ndaj tij.

Në këtë kuptim, ankuesi pretendon se veprimet e ndërmarra nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së në Ministrinë e Brendshme, Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, F. Y. dhe ish-Prefektes së Qarkut Berat, V. Z., janë kryer me synimin për ta larguar nga puna për shkak të anëtarësimit të tij në LSI.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e situatës diskriminuese dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo

² Pika 3 e nenit 15, parashikon se: *“Emërimi, lirimi, pezullimi dhe përjashtimi i punonjësve të nivelit të lartë dhe të mesëm të shërbimit vendor të MZSH-së bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së, me propozim të kryetarit të bashkisë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.”*

³ Pika 2 e nenit 17, parashikon se: *“Në rastet e nisjes së procedimit penal ndaj punonjësit të shërbimit të MZSH-së, pezullimi fillon në momentin kur punonjësi merret në cilësinë e të pandehurit nga organi i ngarkuar me ligj.”*

juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe formularit të ankesës, ai pretendon se situata diskriminuese ndaj tij ka ndodhur **më datë 11.12.2017**, kur ndaj tij është urdhëruar pezullimi nga detyra për shkak se po ndiqet penalisht nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Gjithashtu, ankuesi sqaron se ka marrë dijeni lidhur me situatën diskriminuese të pretenduar më **datë 28.12.2017**.

Sa më sipër, Komisioneri me anë të e-mailit datë 22.10.2020 dhe kontaktit telefonik të depozituar në ankuesë, ka kontaktuar ankuesin për të marrë informacion më të plotë lidhur me situatën diskriminuese të pretenduar. Nëpërmjet bisedës telefonike ankuesi ka sqaruar inspektorin e çështjes se, pavarësisht faktit që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat pushimin e çështjes, ajo vijon të shqyrtohet nga kjo e fundit dhe nuk është marrë një vendim përfundimtar, sa i përket procedimit penal të nisur. Ky informacion iu kërkua ankuesit ta dërgoj edhe nëpërmjet email-it, por nuk u vu në dispozicion të KMD-së.

Në kontekst të sa mësipër, ankuesi ka marrë dijeni për pezullimin e marrëdhënieve të punës (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), që në datën **28.12.2017**. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën **20.10.2020**, pra më vonë se një vit nga marrja dijeni. Po ashtu, ankuesi ka pohuar se diskriminimi ndaj tij ka ndodhur me datë **11.12.2017**, datë në të cilën ka dalë urdhëri për pezullimin e tij nga detyra.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”, ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.*

PËR KËTO ARSYE:

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/dh të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së L. S., për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)